



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.119/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Faton Bajrami dhe Nenad Laziq, anëtarë, lidhur me ankesën e Arbër Emini, kandidat i pavarur për Kryetar në Komunën e Klllokotit, për shkak të parregullsive në Raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale për kryetar në Komunën e Klllokotit të mbajtura më 09 Nëntor 2025, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.A.nr.433/2025, të datës 12.11.2025, në seancën e mbajtur me datë, 18.11.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Arbër Emini, kandidat i pavarur për Kryetar në Komunën e Klllokotit, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZL.A.nr.433/2025, të datës 12.11.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZL.A.nr.433/2025, të datës 12.11.2025, është vendosur: "HEDHET E PALEJUAR ankesa ZL.Anr.433/2025, e datës 10.11.2025, e parashtruar nga Arbër Emini, kandidat i pavarur për kryetar në Komunën e Klllokotit, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive për Raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale për kryetar në Komunën e Klllokotit, i mbajtur më datë 09 Nëntor 2025".

Kundër vendimit të lartpërmendur, Arbër Emini, kandidat i pavarur për kryetar në Komunën e Klllokotit, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën i konteston rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve, gjegjësisht pretendon se është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacioni zgjedhor gjatë procesit të votimit të raundit të dytë të zgjedhjeve lokale për Kryetar Komune në Klllokot, konkretisht për shkak të lejimit dhe pjesëmarrjes së kandidatit z.Srecko Spasic, si person i cili nuk plotësonte kushtet ligjore për kandidim, gjë që ka cenuar integritetin kushtetues, ligjshmërinë dhe rregullsinë e procesit zgjedhor në Komunën e Klllokotit, me propozim që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën si të bazuar, pasi që PZAP nuk i është përgjigjur ankesës së tij për raundin e dytë dhe nuk ka trajtuar aspak kandidaturën e Kryetarit të Komunës Paralele të VITIS Strecko Spasic dhe pjesëmarrjen e tij në balotazh në Klllokot. Pastaj ka kërkuar që të mos urdhërohet mos certifikimi i rezultateve të rundit të dytë në Klllokot, ashtu që të decertifikohet kandidati Srecko



Spasic, si dhe të shpallet i pavlefshëm raundi i dytë i zgjedhjeve në Komunën e Klllokotit që është mbajtur me pjesëmarrjen e kundërligjshme të Spasic, dhe të urdhërohet përsëritja e raundit të dytë për Kryetar të Komunës së Klllokotit me vetëm dy kandidatë legjitim më të votuar, Arbër Emini dhe Bozidar Dejanovic.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të kandidatit të pavarur për Kryetar të Komunës së Klllokotit Arbër Emini, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e kandidatit të pavarur për Kryetar të Komunës së Klllokotit Arbër Emini, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZL.A.nr.433/2025, të datës 12.11.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i më datë 10.11.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.433/2025, nga Arbër Emini, kandidat i pavarur për kryetar në Komunën e Klllokotit, të paraqitur kundër KQZ-së, me të cilën pretendon se në bazë të vendimit nr.22/2025, të Presidentes së Republikës së Kosovës, janë shpallur zgjedhjet lokale në të gjitha komunat e vendit, përfshirë edhe Komunën e Klllokotit, KQZ certifikoi katër kandidat për kryetar komune në këtë komune meqenëse asnjeri kandidat nuk e kaloi pragun prej 50% + 1 votë, sipas Ligjit për Zgjedhjet Lokale shkuan drejtë raundit të dytë me dy kandidatët më të votuar: Bozidar Dejanovic dhe Srećko Spasic. Ky i fundit njoftoi publikisht se i bashkohej Listës Serbe, partisë dominuese të serbëve në Kosovë, cila gëzon mbështetje të plotë politike dhe financiare nga Serbia. Në njoftimin zyrtar të publikuar nga Lista Serbe theksohet se Spasic së bashku me të gjithë anëtarët dhe këshilltarët e subjektit të tij "besojnë pa rezerva në presidentin e Serbisë". Kjo konfirmon bashkimin e dy subjekteve politike që në këtë fazë të procesit zgjedhor ligjërisht nuk mund të bashkohen, duke krijuar koalicion të ndaluar dhe duke e lënë votuesin pa alternativë reale, por sipas parashtruesit të ankesës raundi i dytë i zgjedhjeve në Klllokot është zhvilluar në rrethana antikushtetuese dhe të paligjshme, pasi është lejuar në garë një person i cili vepron në dëm të Republikës së Kosovës dhe publikisht ka bërë të qartë se emri i tij është vetëm në letër por jo në garë, kjo ka deformuar vullnetin e zgjedhësve dhe më ka vendosur në një disavantazh të padrejtë. Sipas ankuesit, po të respektohej Kushtetuta dhe ligji, Spasic s'duhej të ishte fare i lejuar në balotazh dhe në vend të tij në raundin e dytë do duhej të konkurronte kandidati pasues që është ankuesi. Parashtruesi i ankesës pretendon se lejimi i Spasic jo vetëm që i ka mohuar mundësinë legjitime për të garuar në balotazh por gjithashtu ka vënë në dyshim legjitimitetin e gjithë procesit në këtë komunë.

Për më tepër, ekzistenca e parregullsive të dokumentuara, siç ishte votimi me asistencë i mundësuar nga certifikata mjekësore të lëshuara ilegalisht nga struktura paralele, e bënë më të qartë sipas ankuesit edhe rezultatin e raundit të parë mund të jetë ndikuar në mënyrë të kundërligjshme. Në bazë të këtyre, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që të aprovoj ankesën si të bazuar, të decertifikojë kandidatin Srećko Spasic, respektivisht të konstatoj papranueshmërinë ligjore të kandidaturës së tij dhe t'i heq atij certifikimin si kandidat për



kryetar komune me efekt prapaveprues si dhe të shpallë të pavlefshëm raundin e dytë të zgjedhjeve në Komunën e Klllokotit dhe përsëritjen e tyre. Si prova, në ankesë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur njoftimin zyrtar të publikuar nga Lista Serbe dhe vendimin e qeverisë së Serbisë që e emëron Screcko Spasic si "president të Organit të përkohshëm të Komunës së Vitisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në përgjigje në ankesë ka deklaruar me vendimin nr.01/1105-2025, të datës 11.06.2025, ka miratuar Planin e Aktiviteteve për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të datës 12 Tetor 2025. Procesi i aplikimit dhe certifikimit të subjekteve politike dhe kandidateve të tyre është zhvilluar sipas planit të lartcekur. Afati për aplikim për certifikim të subjekteve politike dhe kandidateve të tyre ka qenë nga 26 Qershori deri me 13 Gusht 2025. KQZ më tej ka theksuar se tërheqja apo zëvendësimi i kandidateve dhe subjekteve politike bëhet në pajtim me LZP, nenin 29 dhe Rregulloren Zgjedhore nr.04/2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe kandidateve të tyre neni 5. Afati sipas planit të aktiviteteve për tërheqje apo zëvendësim të kandidatëve ka qenë nga 23.08.2025 deri me 02.09.2025. Për Komunën e Klllokotit, në këtë proces zgjedhor kane qenë të certifikuar: 7 subjekte politike për Kuvend Komunal dhe 4 kandidatë për Kryetar Komune. Kriteret për certifikim janë vlerësuar dhe miratuar duke u bazuar në Kapitullin IV të LZP Certifikimi i kandidatëve, si dhe Rregulloren Zgjedhore nr.04/2024 për Certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidateve të tyre. Po ashtu Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike nuk ka pranuar asnjë kërkesë për tërheqje të kandidatëve për Komunën e Klllokotit apo nga ndonjë subjekt politik gjatë afatit të përcaktuar ligjor. KQZ, pas përfundimit të raundit të parë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 12 Tetor 2025, ka certifikuar rezultatet e raundit të parë për zgjedhjet për kryetar komune, në mesin e tyre edhe për Komunën e Klllokotit, sipas vendimit nr.01/3128-2025 të datës 03.11.2025. Në Komunën e Klllokotit, për raundin e dytë, sipas rezultateve të certifikuara nga KQZ, kanë shkuar dy kandidate: Bozidar Dejanovic nga subjekti politik Srpska Lista me 893 vota ose 41.38% dhe Screcko Spasic nga subjekti politik "Srpska Narodna Sloga" me 647 vota ose 31.23%.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Arbër Emmini kandidat i pavarur për kryetar në Komunën e Klllokotit, e paraqitur kundër KQZ-së ku ka pretenduar se i është mohuar e drejta për të qenë kundër kandidat në balotazh pas tërheqjes së Screcko Spasic është e palejuar. Neni 106 paragrafi 1 i LZP-së, përcakton se KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo ankesë ndaj vendimeve të PZAP-ja lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës. Po ashtu neni 106 paragrafi 4 i LZP-së përcakton se rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese kur janë certifikuar nga KQZ-ja.

Paneli vlerësoi se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës kanë të bëjnë me raundin e parë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 12 Tetor 2025, e megjithatë ankesat e paraqitura për parregullsitë e pretenduara për raundin e parë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 12 Tetor 2025 janë përfunduar dhe vendosur nga PZAP-i dhe Gjykata Supreme e Kosovës. KQZ-ja ka certifikuar rezultatet e raundit të parë për zgjedhjet për kryetar komune.



e tyre ka certifikuar rezultatet edhe për Komunën e Klllokotit, sipas vendimit nr.01/3128-2025 të datës 03.11.2025, ku në Komunën e Klllokotit për raundin e dytë, sipas rezultateve të certifikuara nga KQZ, kanë shkuar dy kandidatë: Bozidar Dejanovic nga subjekti politik Srpska Lista me 893 vota ose 41.38%, dhe Scresko Spasic nga subjekti politik "Srpska Narodna Sloga" me 647 vota ose 31.23%. Po ashtu sipas njoftimit zyrtar të KQZ, Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike rezulton se nuk ka pranuar asnjë kërkesë për tërheqje të kandidatëve për Komunën e Klllokotit apo nga ndonjë subjekt politik gjatë afatit të përcaktuar ligjor.

Andaj, nisur nga të lartcekurat duke u bazuar në nenin 106.4, rezultatet e certifikuara janë përfundimtare dhe detyruese dhe rrjedhimisht ndaj vendimit të KQZ-së për certifikim e rezultateve të zgjedhjeve nuk mund të ushtrohet ankesë, andaj bazuar në nenin 115.1 dhe 106.4 u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me hedhjen si të palejuar të ankesës së Arbër Emini, kandidat i pavarur për Kryetar në Komunën e Klllokotit, ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive për Raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale për kryetar në Komunën e Klllokotit, i mbajtur më datë 09 Nëntor 2025. Kjo gjykatë vlerëson se vendimi i PZAP është i drejtë, i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme lidhur me hedhjen si të palejueshme të ankesës, nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara lidhur me parregullsitë në Raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale për kryetar në Komunën e Klllokotit, i mbajtur më datë 09 Nëntor 2025, nuk janë shqyrtuar, pasi që ankesa e ankuesit në fjalë ka rezultuar se është e palejueshme.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokot, Arbër Emini, për shkak të parregullsive në raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale për kryetar në Komunën e Klllokotit, i mbajtur më datë 09 Nëntor 2025, respektivisht parregullsive të pretenduara nga ankuesi lidhur me procesit zgjedhor për shkak të lejimit dhe pjesëmarrjes së kandidatit z. Srecko Spasic, si person i cili nuk plotësonte kushtet ligjore për kandidim në Komunën e Klllokotit, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate nuk janë shqyrtuar në mungesë të lejueshmërisë së paraqitjes së ankesës nga ankuesi. Kjo për faktin se PZAP, me rastin e hedhjes si të palejuar të ankesës së ankuesit, si në vendimin e atakuar, me të drejtë ka vlerësuar se ankesa ka të bëjë me raundin e parë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 12 Tetor 2025, ndërsa ankesat për raundin e parë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 12 Tetor 2025, janë përfunduar dhe vendosur nga PZAP-i dhe Gjykata Supreme.

Nga kjo rrjedh se është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP, se ankesat e paraqitura për parregullsitë e pretenduara për raundin e parë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 12 Tetor 2025 janë përfunduar dhe vendosur nga PZAP-i dhe Gjykata Supreme, KQZ-ja ka certifikuar rezultatet e raundit të parë për zgjedhjet për kryetar komune, ku në mesin e tyre ka certifikuar rezultatet edhe për Komunën e Klllokotit, sipas vendimit nr.01/3128-2025, të datës 03.11.2025, ku në Komunën e Klllokotit për raundin e dytë, sipas rezultateve të certifikuara nga KQZ, kanë



shkuar dy kandidatë: Bozidar Dejanovic nga subjekti politik Srpska Lista me 893 vota ose 41.38%, dhe Scresko Spasic nga subjekti politik "Srpska Narodna Sloga" me 647 vota ose 31.23%. Po ashtu sipas njoftimit zyrtar të KQZ, Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike rezulton se nuk ka pranuar asnjë kërkesë për tërheqje të kandidatëve për Komunën e Klllokotit apo nga ndonjë subjekt politik gjatë afatit të përcaktuar ligjor.

Në lidhje me këtë, me nenin 106 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/l-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP-së, është përcaktuar se: *"KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo ankesë ndaj vendimeve të PZAP-ja lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës".* Ndërsa me paragrafin 4 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: *"Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja. KQZ-ja i publikon rezultatet e zgjedhjeve pasi që ato të jenë certifikuar. Sekretariati i KQZ-së i publikon këto rezultate përfundimtare në formë tabelore duke përfshirë edhe publikimin në faqen e vetë të internetit".*

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e ankuesit lidhur me ligjshmërinë e vendimit të PZAP janë të pabazuara, për faktin se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm nga rezulton se PZAP drejtë ka vendosur lidhur me hedhjen e ankesës si të palejueshme. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuar se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.


Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
AA.nr.119/2025, datë 18.11.2025

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik




GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Sheji i shkresës AA-119/2025
Oznaka spisa:

PLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LIČNO DOSTAVLJANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas kësaj së lajmërit banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fëmijë, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ina izvršiti ni pošte ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena, odaslom članu domaćin. Primaoca naslojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vrata stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më 19.11.2025 201 _____ në ora 09:50 _____

_____ u _____ cas.

Shkak i refuzimit të marrjes _____

Razlog adojanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Numri i shjojave: _____
broj priloga

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:
AA16046111
18.11.2025

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zameni)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.